REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:254874
Datë: 19.11.2019
Numri i dokumentit: 00660394

C.nr.10/2017

GJYKATA THMELORE E PËJËS – DEGA NË KLINË, **Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Fatmir Dobraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit:M Z R nga fshati Z K.Klinë, i perfaqesur nga C G avokate ne K ,sipas autorzimit kundër të padituri M GJ V me vendbanim te fundit ne fsh.N e Z K.Klinë ,tani me vendqendrim te panjohur , të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshme Av.Zef Marleku nga Klina, për shkak të vërtetimit të pronësisë,vlera e kontestit 1000euro pas mbajtjes se seances të shqyrtimit kryesor publik te dt.15.11.2019, në prezencën te paditesit dhe të autorizuarit të paditësit si dhe të Përfaqësuesit të Përkohshëm Av.Zef Marleku, dhe me dt.18.11.2019 mur këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit **SI E BAZUAR**.

I. **VËRTETOHET**: Se paditësi M Z R nga fsh.Z K.Klinë, në bazë të mbajtjes, është pronarë i palujtshmërisë se parcelles numër.- P-71011066-00259-0, në sipërfaqe prej 6684m^2 Zk-Z K.Klinë.

II. **DETYROHET i** padituri: M GJ V nga fsh.N e Z K.Klinë , që t'ia pranojnë të drejtën e pronësisë paditësit, dhe t'ia lejojnë regjistrimin e të drejtës së pronësisë në Librat Kadastrale pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Klinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më detyrim.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta proceduarale.

A r s y e t i m

Paditësi M (Z)R përmese te autorizuarit te tij ne këte gjykate me dt. 11.01.2017.kunder te padituri ka ushtruar padi per vertetim pronesie ku e ka parashtrua çeshtjen ne vijim ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke deklaruar se këtë patundshmëri e ka blerë nga i padituri M Gjok V si dhe familjaret e tij ,para 60 vitesh parcellen kadastrale nr. P-7101106600259-0, në sipërfaqe prej 6684m^2 Zk-Z K.Klinë,ku te gjitha transaksionet jane permbushur ne menyre reciproke nga pala blersi ia ka paguar ne tersi qmimin e kontraktuar mirëpo të njëjtat nuk i ka bartur në emër të tij. Qe atëherë ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj patundshmërie pa u penguar nga askush dhe kërkon nga gjykata që t'i obligojë të padituritë që të ia pranojnë këtë të drejtë në emër të paditësit të cilat patundshmëri evidentohen në emër të të padituri: Duke propozuar që padia dhe kërkesa e tij të aprovohet në tërësi si e

2019:254875

bazuar dhe meqenëse nuk ka asgjë kontestuese lidhur më objektin e shqyrtimit krejtë këto përpos me provat të argumentuar është vertëtuar se me deponimin e deshmitareve e sidomos me daljen e gjykates ne vende me ekspertizen e ekspertit gjeodet sikurse me provat tjera gjendjen faktike ne kete çeshtje juridike civile është vertetua ne menyre te plote .Se paditesi e kete pronen lendore e ka blere nga pronari dhe ka ndertuar shtepit familjare te banimit ne te cilen jane me antaret e familjes .Dhe se është vërtetuar nga keto shkaqe se ne menyre te plote eshte verteua baza juridke e padise dhe themelsia juridike i kerkesepadise ,prandaj i propozoje gjykates qe padin dhe kerkese padin te aprovoje si te drejte dhe te bazuar me qellim qe paditesi si titullar i prones lendore ti realizoje te drejtat pronesore te garantuara me ligj por edhe për siguri juridke nga momenti i regjistrimit te prones ne emer te tij ne baze te vendimit gjyqesore.shpenzimet nuk i ka kërkuar specifikuar.

Gjykata për ti krijuar kushtet procedurale në ketë çështje kontestimore ne kuptim të nenit 79 parg 3 pika a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës, te padituri: :M Gjoke V nga fsh. N e Zit K.K tani me adresë të panjohur , ia caktoj përfaqësuesin e përkohshëme av.Zef Marleku nga Klina ,me qellim të mbrojtjes se interesit të tij ne ketë konteste, i cili aktvendim u publikua ne gazetën zyrtarë me dt.19.12.2017 dhe me dt.07.07.2017, është afishuar në tabelën e shpalljeve në gjykate, dhe me dt.05.03.2018, është njoftuar Qendra per pune sociale ne Klinë,

Përfaqësuesi i përkohshëme të padituri M V, avokat Zef Marleku nga Klina, ka prezantuar në seancat që janë mbajtur pranë kësaj gjykate dhe në parim e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, mirëpo nuk e ka kundërshtuar provat siç është dalja e gjykatës në vend së bashku me ekspertin gjeodet si dhe nxjerrjen e provave të propozuara nga paditësi si në padi dhe gjatë seancave të mbajtura pranë kësaj gjykate, dhe ka deklaruar se ka insituar vazhdimishte te gjej adresn e tij apo te kontaktoj mirpo siaps opnjonit se i njeti me familjen e tj jeton ne A ne adres te pa njohur.Por se ne kete njesi kadastrale e cila eshte objekte kontesti qka do te thote se e mbajne me mirbesim me tepre se 40 vite .nga krejt kjo pasiqe une jame perfaqesu i perkoheshem i te padituri dhe nuk ma mundeson ligji qe ti njohe te drejten e prones andaj ia le gjykates ne vendosje siaps ligjit.

Andaj gjykata në mënyrë që të bëje vërtetimin e gjendjes se plote faktike dhe sipas propozimit të palëve ndëgjyqëse në procedurë, ka bërë administrimin e provave si në vijim:Leximin e çertifkates se prones me nr.10-12016.leximin e procverbalit te dt.05.06.2018,proceverbalin e dt.26.10.2018,me degjimin e dëshmitarit U U,dhe B D.shiqohet dokumenti indetifikues me nr.... ne emer te M R, shiqohet dhe lexohet raporti i ekspertit gjodet Bajrush Shala i datës 12.08.2018.

Pasi që Gjykata bëri vlërsimin e secilës provë veç e veç,dhe të gjitha se bashku e në lidhëshmeri me njëra tjetrën,e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,arriti në përfundim se në ketë çështje juridike- kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të ketij aktgjykimi pasi që:

Gjykata me propozimin e paditësit bërë dëgjimin e dëshmitarit:U U i identufikuar sipas nr.personal.... të leshuar nga MPB-Prishtinë.Cili deklaron se paditësin për nga afërsia janë kojshi dhe shtepia e tij me te Mes eshte afer 200metra . ndërsa për pronën kontestuese dëshmitari dëshmoj se i kujtohet shum mire kur është blerë kjo patundshemri i ka rreth 60 vitesh kur është blere,ne pyetje të gjykates ,i kujtohet mir kur e ka blere .dhe ka degjuar se kane blere edhe pse nuk kame pasur njohuri por jam informuar qe jan ka e blejn ketë toke .Me kujtohet se ka qene shuma diku 4 milion e gjysme dinare te athershem ,ku ja kan dhene te gjitha .Pasi është blere keta kan ardhur se kan jetuar ne B dhe athert kan ardhur ketu ne kete parcelle ne fshatin Z K.K Ku jan vendosur dhe kan ndertuar edhe shtepi dhe prej atherit asaj dite deri me sot jetojne ku dhe tani askush nuk i ka penguar dhe te nejtit jetojen ne kete parcell,ku ka pasur shteipi te vejtra dhe tani i kan ndertuar dy shtepi nga dy kate.

Gjykata me propozimin e paditësit bërë dëgjimin e dëshmitarit:B D i identufikuar sipas nr.personal.1002658875 të leshuar nga MPB-Prishtinë.Cili deklaron se paditësin për nga afërsia janë kojshi . ndërsa për pronën kontestuese dëshmitari dëshmoj se se jetonin ne ate ngaster dhe asnjeher nuk ka pasur problem nga askush dhe nga as i padituri dhe te gjitha te hollat jan paguar.Ne pyetje te gjykates ,ne kemi ardhur pra 40 vitiesh aty ne kete fshate dhe ne i këmi gjetur aty .Keta kan ardhur prej B dhe une i kam miq aty dhe i kam njohur babagjyshin dhe baben dhe Men .Dhe prej se kam ardhur une e dij qe është duke e punuar qe ne vitin 1982 qe kam ardhur perafresishte 10 vjete pa adhur une aty .Dhe ne te nejtitn vende jane vendosur .Ku ka qen e ndertuar nje shtepi dhe ate shtepi e kan prishur sepse e ka mare rruga Peje Prishtin qe është ndertuar.

Gjithashtu në cilësi të provës gjykata bëri shqimin dhe leximin e *certifikatës se pronës-P-7101106600259-0, në sipërfaqe prej 6684m^2 Zk-Z Klinë, të cila evidentohen në emër të të paditurit.* si dhe leximit të ekspertizës se ekspertit Bajush Shala e datës 12.06.2018 ku ka vetëtuar gjendjen faktike dhe me propozimin të palës paditësë gjykata ka dalë në tërenë se bashku me ekspertin gjeodet në ngastren kontëstues dhe e është vetëtuar gjendjen faktike sipas procësverbalit të dt.05.06.2018,se sipas gjendje faktike ne tëren se ne pjesen lindore është e ndare me kufi me prone fqinje i cili kufi është me rrethoja te metalit nje pjese me bagrena dhe nje pjese tjeter është garazhe e prones fqinje ndersa me pjesen tjeter me asfallte ,rrugë publike.Ne pjesën veriore kufizohet me parcellen fqinje me kufi me mrezha rrjete metali ndresa nje pjese me muri.Ne pjesen jugore kfizohet me rrug magjistrale Peje –Kline dhe me kufinje me shemshire bredha.Ne pjesen lindore kufizohet me pronen fqinje me kufije te ndare me mure me blloka e betonit.Ku jan te ndertuar shtepi nje ne pjesen perendimore e karakterit P-0 ndresa ne pjesen veriore eshte e ndertuar nje shtepi e karakterit P-1,ndresa ne qender është e ndertua nje shtepi e karakterit P-2K.si dhe ne baze te ekspertizes se ekspertit gjeodet,ku ja fali besimin ne tersi dhe së është vërtetuar se paditësi është në shfrytëzim dhe posedim faktik të kësaj patundshmërie, e këndej dhe asnjëherë nga të padituri nuk është kundërshtuar ndërsa nga kontrata gojore mbi shitblerjen e tokës e vërtetuar nga deklarimet e palëve në procedurë, vërtetohet fitimi i pronësisë i ketyre ngastrave kontestuese. Andaj gjykata ju fali besimin ne tersi deshmitarit U U sipas deshmis se tij te dhen me dt.19.09.2019 dhe deshmitarit B D te dhen pran kesaj gjykate me dt.15.11.2019,si dhe ekspertize e ekspertit gjeodet te dt.12.06.2019,se te nejtat ishin ne perputhshmeri me provat ne shkresat e lendes .andaj gjykat ka ardhur në përfundim se padinë e paditësit duhet aprovuar në tërësi si e bazuar.

Nga vërtetimi i këtillë i gjendjes faktike gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi M R nga fshati Z Klina , në bazë të të gjitha provave të vërtetuara në shqyrtimin kryesor, është bërë pronar legjitim i palujtshmeris në bazë të blerjes dhe mbajtjes si dhe duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, në të cilin është përcaktuar se "Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshëmri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të", andaj në rastin konkret paditësit e ka fituar të drejtën në ngastrat kontestuese me parashkrim, dhe me shitblerje cila gjë vërtetohet me faktin se paditësi dhe paraardhësit e tij juridik këtë patundshmëri e kanë mbajtur më mirëbesim që para 60 vitesh, dhe këtë të padituri asnjëherë nuk e kanë kontestuar.

Lidhur me shpenzime procedurale gjykata nuk vendosi, meqenëse asnjëra nga palët shpenzimet e procedurës nuk i kanë kërkuar-specifikuar, e duke u mbështetur ne dispozitat e nenit 463 te LPK-së.

Nga sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në kuptim të dispozitave të së drejtës nga neni 143, lidhur me nenin 160 të Ligjit për Procedurën kontestimore.

GJYKATA THEMELORE E PEJËS – DEGA NË KLINË
Departamenti i Përgjithshëm – Civil
C.nr.10/17 më datën 18.11.2019.

G j y q t a r i,
Fatmir Dobraj

UDHËZIM JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta ne ankese ,
Ne afate prej 15 ditesh nga dita e marrjes se te njetit
Gjyaktes se apelit ne Prishtin e permes kesaj gjykate.